



THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

Për Organizatat JoFitimprurëse (OJF) për Menaxhimin e Skemës së Granteve në kuadër të Programit Youth Climate Action Fund (YCAF) - Bloomberg Philanthropies

1. Hyrje

Bashkia Durrës është përzgjedhur si një nga qytetet pjesëmarrëse në programin ndërkombëtar **Youth Climate Action Fund (YCAF) – Raundi I (2026–2027)**, një iniciativë globale e themeluar nga Bloomberg Philanthropies dhe e zbatuar në partneritet me Bloomberg Center for Public Innovation në Johns Hopkins University, C40 Cities Climate Leadership Group, United Cities and Local Governments (UCLG) dhe Rockefeller Philanthropy Advisors.

Programi synon të fuqizojë të rinjtë e moshës 15–24 vjeç për të projektuar dhe zbatuar zgjidhje inovative për sfidat klimatike lokale, nëpërmjet një skeme konkurruese të mikrogranteve.

Në kuadër të këtij programi, Bashkia përfiton një grant në vlerën **50,000 USD**, nga të cilat të paktën **40,000 USD** duhet të shpërndahen në formën e mikrogranteve me vlerë **1,000–5,000 USD**, për financimin e **8–50 projekteve klimatike të udhëhequra nga të rinjtë**. Deri në **10,000 USD** mund të përdoren për kostot administrative dhe të menaxhimit të programit.

Për të garantuar një zbatim transparent, efikas dhe në përputhje me kërkesat e programit, Bashkia fton organizatat jo-fitimprurëse të paraqesin shprehjen e tyre të interesit për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit dhe administrimit të skemës së granteve për projektet klimatike për të rinjtë aplikantë.

2. Objekti i Thirrjes

Objekti i kësaj Thirrjeje për Shprehje Interesi është përzgjedhja e një Organizate JoFitimprurëse (OJF), e cila do të mbështesë Bashkinë Durrës në administrimin dhe menaxhimin e skemës së mikrogranteve në kuadër të programit **Youth Climate Action Fund**, duke garantuar zbatimin e të gjitha kërkesave të Programit të financimit, standardeve të transparencës, llogaridhënies dhe menaxhimit financiar.



3. Qëllimi i Partneritetit

Qëllimi i këtij partneriteti është angazhimi i një organizate jo-fitimprurëse me përvojë, e cila do të ofrojë mbështetje teknike, administrative dhe operacionale për institucionin e Bashkisë Durrës për detyrat sim ë poshtë vijon:

- administrimin e skemës së mikrogranteve;
- organizimin e procesit të aplikimit;
- mbështetjen e të rinjve aplikues;
- monitorimin e projekteve të financuara;
- administrimin financiar të skemës së granteve;
- raportimin narrativ dhe financiar ndaj Bashkisë dhe donatorit.

4. Fusha e Shërbimeve

Organizata e përzgjedhur do të ofrojë mbështetje gjatë të gjitha fazave të zbatimit të programit.

Faza I – Projektimi dhe Planifikimi

Organizata do të:

- hartojë dokumentacionin e Thirrjes së Hapur;
- përshtatë formularët e aplikimit dhe udhëzuesit për aplikantët;
- mbështesë Bashkinë në përcaktimin e prioritetëve klimatike;
- hartojë planin e komunikimit dhe promovimit;
- organizojë sesione bashkëkrijimi (Co-design) me të rinjtë;
- koordinojë bashkëpunimin me shkollat, universitetet, organizatat rinore dhe aktorët lokalë.

Faza II – Zbatimi i Thirrjes së Hapur

Organizata do të:

- organizojë dhe promovojë Thirrjen e Hapur;
- zhvillojë sesione informuese;
- ofrojë asistencë teknike për aplikantët;
- pranojë dhe regjistrojë aplikimet;
- kryejë kontrollin administrativ të dokumentacionit;
- mbështesë verifikimin e kritereve të pranueshmërisë;
- përgatisë dokumentacionin për Komisionin e Vlerësimit.



Faza III – Menaxhimi i Mikrogranteve

Organizata do të:

- përgatisë kontratat me përfituesit;
- administrojë procedurat financiare të mikrogranteve;
- kryejë pagesat sipas marrëveshjeve të miratuara;
- mbajë dokumentacion të plotë financiar dhe administrativ;
- sigurojë përputhshmërinë me rregullat e donatorit;
- administrojë bazën e të dhënave të përfituesve.

Faza IV – Monitorimi dhe Mbështetja Teknike

Organizata do të:

- organizojë trajnime dhe sesione orientuese për përfituesit;
- ofrojë mentorim gjatë zbatimit të projekteve;
- zhvillojë vizita monitorimi në terren;
- mbledhë raportet periodike;
- verifikojë rezultatet dhe indikatorët e projekteve;
- mbështesë përfituesit në raportimin financiar dhe teknik;
- identifikojë rreziqet dhe propozojë masa korrigjuese.

Faza V – Komunikimi dhe Promovimi

Organizata do të:

- mbështesë komunikimin publik të programit;
- dokumentojë historitë e suksesit;
- përgatisë materiale promovuese;
- organizojë ceremoninë e ndarjes së granteve dhe aktivitetin përmbyllës;
- promovojë rezultatet dhe ndikimin e projekteve të financuara.

Faza VI – Raportimi

Organizata do të mbështesë Bashkinë në përgatitjen e:

- Raportit të Thirrjes së Hapur;
- Raportit të Shpërndarjes së Granteve;
- raporteve mujore të progresit;



- raporteve përfundimtare të përfituesve;
- Raportit Final të Grantit.

5. Rezultatet e Pritshme

Në përfundim të kontratës pritet që organizata të ketë realizuar:

- administrimin transparent të skemës së granteve;
- organizimin e një Thirrjeje të Hapur gjithëpërfshirëse;
- mbështetjen teknike të aplikantëve;
- financimin e projekteve në përputhje me kërkesat e programit;
- monitorimin dhe dokumentimin e rezultateve;
- raportimin e plotë teknik dhe financiar.

6. Kriteret e Pranueshmërisë

Organizatat duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jenë organizata jofitimprurëse të regjistruara sipas legjislacionit shqiptar;
- të kenë minimumi pesë (5) vite përvojë pune;
- të kenë përvojë në administrimin e granteve;
- të kenë përvojë në zbatimin e projekteve të financuara nga donatorë ndërkombëtarë;
- të kenë përvojë në projekte me të rinjtë;
- përvoja në fushën e klimës dhe mjedisit përbën avantazh;
- të disponojnë kapacitete administrative dhe financiare të mjaftueshme;
- të mos ndodhen në konflikt interesi.

7. Personeli Kyç

Organizata duhet të propozojë minimalisht ekspertët e mëposhtëm me kohë të plotë (full-time) dhe/ose të pjesshme (part-time):

- Drejtues Projekti;
- Menaxher i Skemës së Granteve;
- Specialist Finance dhe Administrate;
- Specialist Monitorimi dhe Vlerësimi;
- Specialist Komunikimi.



8. Kriteret e Vlerësimit

Kriteri	Pikët
Përvoja institucionale	20
Përvoja në administrimin e granteve	25
Përvoja në projekte rinore	15
Përvoja në projekte mjedisore/klimatike	15
Metodologjia e propozuar	15
Kapaciteti i ekipit	10
Totali	100

Vlerësimi i organizatave aplikante do të behet nga Komisioni i Vlerësimit i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Komisioni i vlerësimit të aplikimeve është organ i krijuar nga Bashkia Durrës i cili realizon vlerësimin e aplikimeve të dorëzuara në përputhje me rregullat e programit të financimit nga Bloomberg Philanthropies dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen për shprehjen e interesit.

Për t'u konsideruar për përzgjedhje, aplikanti duhet të sigurojë të paktën **70 pikë** në vlerësimin teknik.

9. Dokumentacioni i Aplikimit

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Letër Shprehjeje Interesi;
- Profilin e organizatës;
- Certifikatën e regjistrimit;
- Statutin;
- Certifikatën e regjistrimit tatimor (NIPT);
- Strukturën organizative;
- Metodologjinë e punës;
- Përshkrimin e përvojës së ngjashme;
- Listën e kontratave/projekteve të ngjashme;
- CV-të e ekspertëve kyç;
- Pasqyrat financiare të dy viteve të fundit;
- Deklaratë për Mungesën e Konfliktit të Interesit.



10. Kohëzgjatja e Marrëveshjes së Partneritetit

Marrëveshja e Partneritetit ndërmjet institucionit të Bashkisë Durrës dhe OJF-së së përzgjedhur, pritet të nënshkruhet brenda muajit **korrik 2026** dhe të përfundojë në muajin **Maj të vitit 2027**, duke mbuluar të gjithë ciklin e zbatimit të programit.

11. Mbikëqyrja dhe Raportimi

Organizata e përzgjedhur do të punojë nën mbikëqyrjen e Bashkisë dhe në bashkëpunim të ngushtë me Koordinatorin e Programit.

Ajo do të paraqesë raporte periodike teknike dhe financiare, do të marrë pjesë në takimet koordinuese dhe do të mbështesë Bashkinë Durrës në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të raportimit ndaj donatorit.

12. Standardet Etike

Organizata e përzgjedhur duhet të respektojë parimet e:

- transparencës;
- llogaridhënies;
- trajtimit të barabartë;
- mosdiskriminimit;
- pjesëmarrjes aktive të të rinjve;
- integritetit;
- parandalimit të mashtrimit dhe korrupsionit;
- ruajtjes së konfidencialitetit;
- shmangies së konfliktit të interesit.

13. Dorëzimi i Shprehjes së Interesit

Organizatat e interesuara ftohen të paraqesin Shprehjen e tyre të Interesit brenda **datës 27 korrik 2026, ora 16:00.**

Aplikimet duhet të dërgohen në adresën elektronike:

E-mail: info@durres.gov.al



**Bloomberg
Philanthropies**

Ose në rrugë zyrtare në Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun në adresën:
Sheshi “Liria”, Nr. 1, Durrës

me titull:

**“Shprehje Interesi për OJF-të – për Menaxhimin e Skemës së Granteve në kuadër të
Youth Climate Action Fund”.**

Aplikimet e dorëzuara pas afatit ose të paplota nuk do të merren në shqyrtim.